



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 07.04.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.
2. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 30.03.2023 dhe 04.04.2023
3. Mbi ditën e fillimit të tregtimit të tregut të Ditës në Avancë të ALPEX.
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 203 datë 13.09.2018.
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.09.2018.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferim (nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik Blue 1, në favor të Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, SICAV-SIF.
7. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2022, “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së “ALBGAZ” sh.a.”.